



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXIX-të (njëzetënentë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 06 janar 2025

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, znj.Fikmete Qurkolli, z.Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishte Zita Rasztk përfaqësuese nga KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, në vazhdim lexon rendin e ditës, vazhdon vlen të theksohet se pikë 2 të rendit të ditës mirëpo Njësitë për të drejtat e njeriut në Komunën e Podujevës nuk është prezent dhe ne nuk kemi çfarë të paraqesim pa e pas një informatë nga ata, kështu që këtë pikë të rendit të ditës propozoj ta shtyjme për mbledhjen e radhës, andaj e hedh në votim këtë propozim.

Njëzëri me 7 vota Për nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, mbështetet propozimi që pika 2 e rendit të propozuar të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës për arsye të mos prezencës së përfaqësuesve të Njësitit përkatës në këtë mbledhje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, tani e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, natyrisht pa pikën 2 e cila paraprakisht u mbështet që të hiqet nga rendi i ditës duke u shtyrë për mbledhjen e radhës.

Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit prezent në mbledhje, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje, me përjashtim të pikës 2 e cila u mbështet paraprakisht që të hiqet.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 03 dhjetor 2024

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, materialin e procesverbalit në fjalë e keni marrë me kohë dhe besoj e keni lexuar, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën nëse jo e hedh në votim.

Njëzëri me 7 vota Për nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 03 dhjetor 2024.

2. Informatë për realizimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, Planin e punës së Komitetit për Komunitete jemi në dijeni se të gjithëve ju është përcjellë dhe gjatë vitit të kaluar kemi punuar sipas këtij Plani. Si Komitet për Komunitet i kemi realizuar të gjitha mbledhjet sipas Planit që kemi pasë për vitin 2024, pastaj vizitat e planifikuara në komunitete i kemi realizuar të gjitha, po ashtu edhe vizitat nëpër shkolla i kemi realizuar ku kemi vizituar nxënësit dhe ku kemi marrë informata rreth vijimit të mësimin të nxënësve të komuniteteve, braktisjes së shkollimit si dhe problemet e ndryshëm të tyre që kanë. Mandej nga Drejtoria e Arsimit kemi marrë të gjitha të dhënat e nxënësve kështu që mund të them se nuk kemi pasë probleme me nxënësit e komuniteteve nëpër shkolla, ka pas disa ngecje të nxënësve të komuniteteve nëpër shkolla të ndryshme por në këtë aspekt së bashku me profesor të shkollave kemi intervenuar kryesisht në mos braktisjen e shkollimit.

Gjatë vitit 2024 i kemi ftuar të gjithë drejtorët e Drejtorive relevante për të na dhënë informata në lidhje me komunitetet në çështjet që ne si Komitet për Komunitete i kemi caktuar e që për fat të mirë pothuajse të gjithë na janë përgjigjur duke na dhënë informata, sugjerime dhe sqarime tjera rreth komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Komunën e Podujevës. Në këtë aspekt falënderoj edhe shefin e Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim z.Liman Zeqiri sepse të gjitha konkurset, thirrjet dhe ftesat që janë shpall për Komunitetet jo shumicë, siç kanë qenë për ndërtim të shtëpive, renovim të shtëpive dhe të tjera, të gjitha dokumentacionet i kemi marrë në këtë Zyrë, na janë shtypur në kopje ato dokumente dhe na janë dhënë, pastaj ata të cilët nuk ka ditë se si t'i plotësojnë janë shkuar te z.Liman Zeqiri i cili i'u ka ndihmuar. Po ashtu një falënderim shkon edhe për z.Agim Hysenin i cili na ka dhënë shumë përkrahje në realizimin e atyre dokumenteve sepse një numër i madh i atyre që kanë aplikuar kanë shkuar tek ai dhe janë ndihmuar për t'i plotësuar, kështu që nuk kemi ngecë në asnjë rast për shkak të dokumentacionit që komuniteti jo shumicë të mos mund të aplikoj me dokumente për renovim të shtëpive, për ndihmë në fushën e shëndetësisë që ka qenë një projekt në qeveri e që të gjithë ata të cilët kanë shpreh gatishmëri të aplikojnë dhe ta kenë dokumentacionin përkatës në rregull dhe të cilët kanë shkuar dhe i kanë realizuar të gjitha to çfarë kanë qenë.

Prandaj unë besoj dhe konsideroj se vitin 2024 e kemi përmbyll me sukses punën e Komitetit për Komunitete duke i falënderuar të gjithë juve që na keni ndihmuar dhe keni marrë pjesë në të gjitha këto aktivitete. Unë nuk kam diçka tjetër rreth këtij raportimi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni nëse jo e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Ngritja e Grupit punues për hartimin e propozim Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me ngritjen e një Grupi punues për hartimin e draftit të Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025. Sipas praktike të mëparshme neve na duhet ta formojmë një Grup punues me rreth 3 ose 5 anëtar nga radhët e këtij Komiteti në mënyrë që të përgatitim dhe hartojmë Planin e punës për vitin 2025, pra modelin e planit e kemi sikurse në vitet paraprake, kështu që urdhëroni mund të fillojmë me propozime të anëtarëve.

z.Arbnor Fazliu, propozon kolegun Demokrat Hodollin.

z.Demokrat Hodolli, edhe unë propozoj kolegun parafolës Arbnor Fazliun.

znj.Sevdije Mustafa, propozon Shkurte Sejdiun

znj.Shkurte Sejdiu, propozon Sevdije Mustafën

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra kemi 4 propozime të anëtarëve për të qen pjesë e këtij Grupi punues, edhe unë në cilësinë e Kryesuesit të Komitetit dhe bëhemi 5 anëtarë.

Po shoh që ka të interesuar për ta propozuar edhe Florent Hasanin mirëpo pastaj duhet të propozohet edhe një anëtar sepse numri i anëtarëve duhet të jetë tek, kështu që urdhëroni nëse dëshironi fjalën, nëse jo atëherë i hedh në votim propozimet e dhëna.

Pas votimit u konstatua se Njëzëri me 9 vota Për, mbështetet propozimi për formimin e Grupit punues për përgatitjen dhe hartimin e draft Planit të punës së Komitetit për Komunitete, në këtë përbërje:

Xhafer Ademi, kryesues i grupit punues,

Demokrat Hodolli, anëtar,

Arbnor Fazliu, anëtar,

Shkurte Sejdiu, anëtare,

Sevdije Mustafa, anëtare

Grupi punues ngarkohet që draft Planin e përgatitur ta procedoj për shqyrtim dhe miratim në një prej mbledhjeve të radhës.

Takimet do të organizohen nga Kryesuesi i Komitetit dhe atë përmes komunikimit me telefon dhe rrjete tjera sociale qoftë për orarin, datën, vendtakimin e të tjera të ngjashme.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, kam një propozim që kërkohet të hyjnë në procesverbal, fjala është për 15 Shkurtin-Ditën e Flamurit të Ashaklinjve, datë për të cilën kërkohen mjete financiare për të organizuar manifestim dhe për këtë duhet të bëhet kërkesë në Komunë për mjete financiare për festimin e 15 Shkurtit Ditës së Flamurit të Komunitetit Ashkalinj, kështu që të hyjë kjo si kërkesë që duhet të bëhet nga Komiteti për Komunitete, do të thotë që dikush nga ne gjithqysh duhet ta bëjë dikush prej neve dhe të njëjtën ta dërgojmë te Kryetari apo në Drejtorinë e Financave, të shikojmë pastaj ku do ta drejtojmë.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën në këtë pikë Të Ndryshme, nëse jo atëherë e konsiderojmë të përfunduar këtë mbledhje.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:25

Procesverbalin e mbajti,

Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0000409/25

Podujevë, 06 janar 2025

Kryesuesi i Komitetit

Xhafer Ademi